

PROCEDURA DHE RREGULLAT PER RREGJISTRIMIN E TE GJITHE STUDENTEVE TE VITIT II DHE III NE SEZONIN

PLOTËSUES (TE MBARTURAVE)

Keto rregulla jane unike per te gjithë studentet e viteve te dyta, te treta, ne te gjitha programet e studimit BACHELOR, te cilet jane te rregjistruar dhe vazhdojne rregullisht studimet ne vitin akademik 2018-2019.

Per sezonin e te mbarturave 2018-2019 kane te drejte te rregjistrohen vetem studentet e vitit te dyte, te trete, te cilet jane te regjistruar paraprakisht ne vitin akademik 2018-2019 :

- a) Studentet qe aktualisht jane ne vit te dyte mund te japin provime vetem nga lendet e vitit te I te cilat i kane frekuentuar paraprakisht.
- b) Studentet qe aktualisht jane ne vit te trete mund te japin provime vetem nga lendet e vitit te I dhe II te cilat i kane frekuentuar paraprakisht.

Studentet duhet te rregjistrohen vete ne lendet qe do te japin provim. Me poshte tregohet rregullat e rregjistrimit.

1. Sezoni plotesues per vitin akademik 2018-2019 eshte: 11 prill - 19 prill 2019.
2. Sa data provimesh do te jene ?.....(3) (16 prill, 17 prill dhe 19 prill)
3. Per nje lende te caktuar sa data provimesh do te lihen ?.....(1)
4. Ne sa provime do te futet studenti ne nje dite ?.....(deri ne 2 provime ne orare te ndryshme)
5. Sa provime mund te jape studenti ne sezonin e te mbarturave?.....(deri ne 6)
6. Studenti mund te prenotohet vetem nje here per te njejtin provim.
7. Per sezonin e te mbarturave rregjistrimi i studenteve per provime do te perfshije periudhen 11 prill – 15 prill 2019.
Sekretarite mesimore duhet te pergatitin paraprakisht grafiket e provimeve.
8. Pas kesaj date asnje student nuk mund te kryeje veprime per rregjistrime ne provimet e sezonit te te mbarturave 2018-2019.
9. Kujtojme se per tu rregjistruar ne sezonin e te mbarturave, te gjithë studentet duhet te jene te pasjitur me te dhenat qe ata kane vendosur vete per te hyre ne sistemin e digjital.
10. N.q.s studentet kane problem me keto te dhena ateherë te komunikojne sa me shpejt me sekretarite mesimore te fakultetit perkates per tu njohur me to.
11. Menyra e rregjistrimit ne provimet e sezonit te te mbarturave 2018-2019 eshte nga vete studenti, sikurse dhe ajo e sezonit te vjeshtes 2017-2018 (online).
12. Ne sezonin e te mbarturave pedagogu qe merr studentet ne provim, eshte ai qe eshte percaktuar ne kurrikulen e studimeve te atij viti akademik (2018-2019) dhe jo pedagogu i vitit te kaluar.
13. Per te gjithë studentet te cilet duan te japin ne sezonin e te mbarturave 2018-2019 lende te cilat i kane patur te pafrekuentura ne kursin e I (viti II) dhe kursin I,II (viti III) por i kane frekuentuar gjate sem I, te vitit akademik 2018-2019 duhet qe para dates 15 prill:
 - a. Te verifikojne ne librezën e tyre online para sezonit, vendosjen e frekuentimit te lendes ne sistemin dixhital te vleresimit.
Ne te kundert studenti nuk do te mund te prenotohet nga websiti i tij ne provimin e kesaj lende per kete sezon.
 - b. Studenti shkon ne websitin e tij dhe rregjistrohet sipas procedurave te percaktuara ne linkun ‘ **Sezonet e provimeve** ’ ne websitin e universitetit : <http://www.unkorce.edu.al>

Kujdes**. Pas dates se provimit studentet nuk mund te rregjistrohen per provim ne kete sezon.**